



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPSTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 45/20

Nr. i fq. / Br. sh - 3 -

Data: / Datum 27.02.2020

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRI

---

**RREGULLORE**  
**(KKV) NR.02/2020 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E**  
**RREGULLORES PËR TARIFA DHE NGARKESA KOMUNALE NR.**  
**278/15 E DATËS. 30.12.2015**

Shkurt, 2020

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2, pika "c", nenit 40, paragrafi 2, pika „a” të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, dt.20.2.2008, nenit 22 dhe 23 i Ligjit mbi Ndërtimin Nr.04/L-110, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.02/2018 për Taksat Administrative për Leje Ndërtimi, Leje Rrënimi dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës, nenit 40, paragrafi 4.2, pika „a” dhe nenit 41, paragrafi 2, pika „c” të Statutit të Komunës 04/2011, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë **27 shkurt 2020** miratoi këtë:

**RREGULLORE  
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TARIFA DHE  
NGARKESA KOMUNALE NR. 278/15 DT. 30.12.2015**

**Neni 1  
Qëllimi**

Qëllimi i ndryshimit dhe plotësimit të Rregullores nr.278/15 për tarifa dhe ngarkesa komunale e datës 30.12.2015, është ndryshimi i taksës për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës sipas dispozitave të UA.nr.02/2018 në sferën e urbanizmit sa i përket aplikimit të tarifave të llogaritjes së taksës për leje ndërtimore.

**Neni 2  
Objekti i rregullimit**

1. Në bazë të kësaj rregulloreje përcaktohen taksat dhe tarifat për dhënien e lejes së ndërtimit si:

- 1.1 Taksa administrative për leje ndërtimore për kategorinë e I-rë të ndërtimit;
- 1.2 Taksa administrative për leje ndërtimore për kategorinë e II-të të ndërtimit;
- 1.3 Tarifat rregulluese për rritjen e densitetit të infrastrukturës;
- 1.4 Taksa administrative për leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe e II-të të ndërtimit.

**Neni 3  
Taksa dhe tarifat për marrjen e lejes ndërtimore**

1. Me këtë rregullore plotësohen dhe ndryshohet neni 9 i rregullores bazë për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale Nr.278/15 e datës 30.12.2015 si në vijim:

- 1.1. Neni 9, paragrafi 1, riformulohet: lartësia e kompensimit për llogaritjen e taksës administrative për kategorinë e I-rë është në vlerë prej 2.00€/m<sup>2</sup> dhe taksa administrative për leje ndërtimore për kategorinë e II-të është 2.92€/m<sup>2</sup> (bruto).
- 1.2. Neni 9, paragrafi 2, ndryshohet vlera e tarifës rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës nga shuma 2.52€/m<sup>2</sup> në 3.50€/m<sup>2</sup> (neto).

1.3. Neni 9, paragrafi 3, riformulohet: lartësia e kompensimit për llogaritjen e taksës për leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të është në vlerë prej 0.84 €/m<sup>2</sup>.

**Neni 4**  
**Dispozitat kalimtare dhe të fundit**

- 4.1. Nenet tjera të Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale me 01Nr.278/15 e datës 30.12.2015 mbeten të pandryshuara.
- 4.2. Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

**Neni 5**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

